

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, mbajtur më **01. 03. 2018**, duke filluar në orën **10.15** në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në mbledhje ishin të pranishëm 36 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësues të mediemeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i KK të Prizrenit, Artan Abrashi.

Për këtë seancë është propozuar ky:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i propozimvendimit për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017.

Jemi njoftuar nga Ministria e Financave lidhur me obligimin që e ka komuna e Prizrenit. Dhe ky obligim ka të bëjë me marrjen e një vendimi që do ta bëjë ky Kuvend lidhur me mjetet e inkasuara nga kategoria e të hyrave vetanake. Siç i keni marrë edhe materialet me kohë. Dhe besoj se tashmë jeni të njoftuar. Nga buxheti paraprak është planifikuar që në vitin 2017 të inkasohen 6.102.106,00 €. Dhe një deficit, apo një shumë e cila është tejkuluar për 1.034.315,00 €. Dhe sipas ligjeve në fuqi, Kuvendi është i obliguar që të marr vendim për rritjen e këtyre të hyrave dhe shfrytëzimin e tyre në projektet të cilat besoj që i keni material. Të gjitha ato projekte ku do të destinohen, ku janë përcaktuar këto mjete janë borxhet e kaluara, apo janë projekte të cilat tashmë duhet të financohen dhe është obligim i komunës që ato mjete ti shpërndajnë. Kjo është dhe për fillim ftoj një përfaqësues të Drejtorisë, që të bëjë njoftime shtesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ertan Simitçi, drejtor i Drejtorisë për Financa: Si tha edhe kryesuesi më herët, komuna e Prizrenit në vitin 2017, ka pasur një buxhet rreth 6.100.000,00 €, për të hyrat vetanake. Me datë deri më 31.12.2017, është inkasuar rreth 7.100.000,00 €. Do më thënë për rreth 1.000.000,00 €, kemi rritje në buxhetin e të hyrave vetjake. Komuna e Prizrenit është e obliguar që këto rritje ti bartë në buxhetin e vitit 2018. Dhe që ti realizoj apo që ti harxhoj ato

mjete. Sipas koordinimit të drejtorëve lidhur me këtë rritje të shumës. Në Drejtorinë e Arsimit është ndarë për paga dhe mëditje. Për shkollat fillore në shumë prej 71.955.00 €. Në shkollat e mesme në shumë prej 25.883.00 €. Për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, për subvencione është ndarë 50.000.00 €. Për projektet kapitale sipas drejtorive: Drejtoria e Administratës dhe Personelit 62.547.00 €. Shërbime Publike rreth 538.807.00 €. Në Drejtorinë e Bujqësisë rreth 34.212.00 €. Në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit rreth 14.299.00 €. Për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Urbanistik 33.825.00 €. Për shërbimet sociale në vlerë pre 21.098.00 €. Dhe për Drejtorinë e Arsimit rreth 61.135.00 €. Gjithsej për investimet kapitale apo për projektet kapitale, shuma është 886.477.00 €. Materialin që e keni pranuar para disa ditëve. Dje nga dy drejtori kemi pasur një kërkesë për një ndryshim të dy projekteve. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, nga kodi 8959589 është emërtimi i projektit ndërtimi i rrugë e lokale në Vlashnje rreth 50.000.00 €. Do të bartet në projektin 43343, ndërtimi i projekteve infrastrukturore. Do më thënë 50.000.00 € do të kalojnë në këtë projekt. Ndërsa në Drejtorinë e Arsimit, ndryshimi nga kodi 89659, transporti i mësimdhënësve udhëtarë. Në vlerë prej 47.051.00 €, kalon në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Do më thënë qeto dy projekte të kenë ndryshim në materialet që i keni ju. Unë si Drejtor i Financave, kërkoj që të mbështetet ky vendim. Për shkak se komuna e Prizrenit në vitin 2017, rreth 3.300.000.00 €, do ta ketë njëfarë obligim financiar, që nuk kemi mund me realizua vitin e kaluar. Në vitin 2017 rreth 2.200.000.00 € do të jetë, që do të bartën mjetet në muajin e ardhshëm që do të bëjmë vendimin për seancë të ardhshme. Edhe me këtë 1.000.000.00 €, ne si komunë e Prizrenit, gati të gjitha obligimet e vitit të kaluar që i kemi është mundësia të mbyllen. Për këtë arsye kërkojmë që të mbështetet nga Kuvendi ky vendim.

Kryesuesi: Tash shkojmë me qëndrimet e grupeve parlamentare, dhe ftoj shefat të japin deklarinimin e tyre lidhur me pikën e rendit të ditës. Pastaj hapim debatin për anëtarët e Kuvendit që dëshirojnë të marrin fjalën.

Simir Krasniqi (PDK): Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të thirrur nga Kryetari i komunës, me këtë rend dite. Shqyrtimi i propozimit të vendimit për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017. Mjetet e planifikuara nga të hyrat vetanake për vitin 2017, kanë qenë 6.102.106.00 €. Kurse në fund të vitit 2017, kemi të inkasuara 7.136.421.00 €. Mbi 1.000.000.00 € më shumë. Apo 1.036.315.00 €. Pra gjatë qeverisjes së Prof. Dr. Ramadan Muja. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së. Falënderojmë qytetarët e komunës së Prizrenit, që duke paguar tatimet dhe taksat nga inkasomi i tyre, kanë rritur të hyrat vetanake mbi 1.000.000.00 €. Ju si kryetar komune do të ishte mirë që për hire të qytetarëve të komunës së Prizrenit, të na njoftoni më herët për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2017. Pasi që për këtë dihet në muajin janar, kurse sot jemi në muajin mars. Ku po shihet mos puna e juaj. Gjithashtu nga ana e juaj si

kryetar komune, do të ishte mirë që të dilni para mediave dhe ti falënderoni qytetarët e komunës së Prizrenit, për kryerjen e pagesave nga tatimet e taksat për vitin 2017. Ku të hyrat vetanake janë rritur mbi 1.000.000.00 €. Dhe atë gjatë qeverisjes të PDK-së. Për punën e mirë që kanë bërë gjatë mandatit të tyre. Dhe jo të jepni intervista, ku ju thonin, që komunën e Prizrenit e kam gjetur në gjendje jo të mirë me 1.300.000.00 €. Ku këtu po shihet një mos seriozitet i punës suaj. Ne si grup parlamentar i PDK-së, mbështesim këtë propozim vendim që është në të mirë të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Jo si kuvendarët e juaj të VV-së, në mandatin e kaluar, çdo propozimvendim që është ardhur nga PDK-ja është kundërshtuar. Edhe pse ka qenë propozimvendim në të mirë të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Shpresoj që këto mjete të taksapaguesve të shfrytëzohen më së mirë që është e mundur.

Adem Shabanaj (LVV): Ne si grup parlamentar i LVV-sje, shprehim keqardhje për këto investime vetanake të komunës së Prizrenit, të realizuara dhe të kthyera në suficit në Prishtinë. Nga se ne nuk mund ti përdorim për investime për projekte dhe investime të reja kapitale. Por duhet të paguhen borxhet e komunës së Prizrenit, të qeverisë Ramadan Muja. Sidoqoftë ne e mbështesim dhe do të votojmë pro këtij propozimvendimi të kryetarit.

Haziz Hodaj (LDK): Sigurisht se grupi parlamentar i LDK-së do ta mbështesë bartjen e këtyre mjeteve për destinacione të cekura në materialin që na është dërgua. Paraprakisht do të doja që me ditë se a është bërë evidencë e saktë e borxheve jo vetëm të vitit të kaluar, po edhe të viteve tjera. A janë evidentua të gjitha projektet që prolongohen me vite të tjera dhe nuk janë të kryera. A llogariten, kjo për drejtorin e Financave, borxhe po e zëmë projektet që janë me vite tash prolongohen. Si shkolla në Piranë, shkolla në Dedaj, shkolla në Lukinaj, biblioteka në qytet. Do më thënë janë një mori projektesh që prolongohen me vite dhe nuk janë të ekzekutuara. Është mirë që në mbledhjen e ardhshme të na jepet një raport i këtyre projekteve, që e kanë kapërcye dinamiken e kryerjes së punimeve. Sepse pushteti ka një kontinuitet dhe vazhdon prej vitit në vit. Atyre që janë brenda dinamikës nuk është problem, sepse janë në kryerje e sipër. Edhe borxhet janë të arsyeshme. Mirëpo projektet që e kanë kapërcye çdo kriter, çdo dinamik. Do duhej ta jepnin në mënyrë që të kërkojmë pastaj mjete shtesë, qoftë në rishikim, qoftë në mundësitë, si kjo që sot po na jepen. Mi destinua mjetet edhe mi krye edhe ato që janë, jo në gjysmë, po janë disa në nisje. Tjetër kisha dashtë, jemi në një situatë tash bukur emergjente këto ditë. Dhe kategoritë sociale kanë kërkesa jo vetëm të njëpasnjëshme te Drejtoria e Emergjencës Sociale. Po edhe tek ne si anëtarë të Kuvendit. Për intervenime urgjente. Sepse njerëzve ju mungojnë edhe gjërat elementare për jetë, dru etj. etj. Ndoshta do të ishte mirë që shumë e caktuar ti destinohet Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Dhe të intervenohet te këto raste. Sepse këto borxhe që janë mbetur deri më tani, kanë mund edhe ndonjë prej tyre

edhe mu shty. Kurse janë raste emergjente, rastet sociale janë që nuk presin, sepse duhet intervenua. Jemi për, për me ia zgjidhë problemin edhe qytetarëve. Gjithsesi do ta mbështesim bartjen e këtyre mjeteve. Sepse është në interesin e qytetarëve të Prizrenit.

Ilir Baldedaj (AAK): Më gëzon fakti që fal Zotit Ministria ju ka zgjuar nga gjumi, në 100 ditshin e qeverisje. Është vendimi i parë që po e merrni dhe është vendim i qeverisjes së kaluar. Sepse deri më sot asnjë vendim nuk e kemi pa nga kjo qeverisje, e cila siç duke nga temperaturat e ftohta ndoshta edhe ju kanë ulë ritmin e punës. Por është e mirë që po ja rikujtoj kolegut nga VV-sja, se të hyrat vetanake nuk shkojnë suficit, po këto kthehen, janë të hyra vetanake. Vetëm grandet dhe subvencionet shkojnë në suficit. Qeverisja e kaluar është akuzuar gjithmonë për keq qeverisje, ka ardhur ndryshimi në qytetin e Prizrenit. Po unë nuk po shoh ndryshim, me premtimet të cilat i ka dhënë kryetari i komunës. Dhe me ato premtime ai është zgjedhur për tu ballafaqua me problemet, dhe për të dal në media për të akuzua për borxhe enorme. Se secili projekt kalon në faza, është i paraparë, fazat e ndërtimit. Do të thotë ka projekte që kanë qenë të planifikuara në buxhet, që është votua nga Asambleja komunale në tri faza, katër faza dhe pesë faza. Dhe natyrisht që ndërrimi i pushtetit, pushteti është katër vjet dhe ndryshohet. Kanë mund ta zënë borxhet ndoshta të cilat janë implementuar punimet dhe ai nuk është borxh. Për deri sa e përmendi z. Hodaj shkollën në Dedaj. Ka pasur telashe me operatorin. Unë e falënderoj Drejtorin e Arsimit i cili ka qenë në gatishmëri, edhe tash. Bile më ka ftuar me një takim ku kam qenë prezent. Po ju kisha lutur mos u merrni shumë me të kaluar, sepse po supozojmë se qytetari e ka dhënë verdiktin për të kaluarën. Vazhdoni punoni sepse ju jeni në gjumë. Ne si grup i AAK-së do ta mbështesim, se kjo është në të mirë të interesit të qytetarëve. Sepse VV-sja edhe procesverbalet në mandatin e kaluar i ka votua kundër.

Kryesuesi: Procesverbalet në atë kohë, i nderuar i ka votuar kundër për shkak të gabimeve gjuhësore. Kemi kërkuar që vazhdimisht me u përmirësua. Dhe mendoj që ka qenë për të mirë, e jo për diçka tjetër.

Baldedaj: Si shprehi Artan e keni pas.

Sinan Alija (Nisma): Grupi i Nismës Socialdemokrate përkrah propozimvendimin. Dhe shpresoj të kaloj.

Sencar Karamuço (KDTP): Ne do të votojmë.

Azem Durmiši (NDS): Stanka NDS isto će podržati planirani budžet i samodoprinos opštine. Uz hteo da naglasim da ozbilnost našeg grada ovde. Da se prenese i na delu tamo kako je. Da planirani i početni projekti koji se tokom

prošle godine a i u buduće da se realizuju. Nadovazao bi se na kolegom koji je rekao Ilir, da se bavimo puno prošlošću. Ali da budućnost da nam bude sjajnija. Uputio bi znači da se ima na umu pre svega konkretno Direktorijatu za Obrazovanja planirani budžeti i po zakonu i po pravilnicima, za grejanje sezone. Da u budućnosti se ima na umu nadmorska visina, gde sredstava za grejanje u školskim objektima, znači učionicima izdvajaju se sredstva na broju učenika. A što je to nerazumljivo za mene a i za ostala mislim da će da podrže. Da nadmorska visina i temperature tokom zimskog perioda, da nije ista ispod 400 metara nadmorskse visine i nad 800 metara nadmorske visine. To bi hteo da naglasim i da se ima na umu dalje za ubuduće da se izdvajaju više sredstva za takve sredine. Znači u ruralnim delovima, da se ima na umu nadmorska visina. Jer zaista poređeno jedno u Prizrenu ajo ke 10 stepeni, a u selima negde iznad 1000 metara nadmorske visine, je temperatura sigurno u minusu. Pa zato bi uputio jedan apel direktoru Direktorijata za Obrazovanje, da ima na umu za ubuduće raspodela tih sredstava. Onda Direktorijat za Zavnu Službu da ima na umu u toku ove godine za obeležavanje linije razdvajanja u saobraćaju. Ja bi hteo da čujem moje kolege da potvrde u drugim delovima naše opštine. Ja kao predstavnik sa sela i od Prizrena do mojeg sela i u ostalim delovima sela Župe, linije na putevima za razdvajanje smerova u saobraćaju su nevidljive. A to ne da bi ovde ja vama pametovao. Jer zaista vozačima su potrebne te linije. Bar u situacijama kada je vidljivost smanjena kao putokaz, i kao vodilje. Direktorijatu za Socijalni Rad, da ima na umu za pomoć socijalnim porodicama za izgradnju stambenih prostora da normalno žive. I to bi izdvoji za ovo najmanje tri stambena prostora. Manastirica jedna, Ljubinj e i Lokvica. I na kraju Javnu službu bi zamolio da već pet, šest godina, dvije ulice u Kurilo, kako se popločavaju, a nikad da se popločaju.

Kryesuesi: Vetëm ta keni parasysht një gjë. Ky rend dite, kjo pikë nuk është rishikim i buxhetit. Është vetëm ridestitim i mjeteve aty ku duhet të paguhen disa obligime ashtu siç e theksuam. Mirëpo, në qoftë se pajtoheni të gjitha projektet që i keni për projekte të reja, apo për të gjitha gjërat e nevojshme. Ti leni për seanca e radhës. Besoj shumë shpejt do ta kemi seancën e radhës. Ku do të paraqisni në drejtori të caktuar, varësisht se çka mendoni që është në interes të qytetarëve.

Memnuna Ajdini (Vaka): Svakako da je ovaj jako dobar predlog obzirom da se radi o nekim investicijama i projektima koji su prolongiranu od 2017 godine. Nadam se da će ubrzo da se izvrše obih projekti. Svakako možda ima nekih sitnih primedbi. Ali nadam se da ćemo imati prilike da neke svoje primedbe damo. Pa da uvrstimo od one prolongirane projekte da se uvrste u plan budžeta za 2018. Koalicija Vakati će podržati ovaj predlog.

Kryesuesi: Tani ftoj ndonjë anëtarë të Kuvendit i cili dëshiron me marr fjalën.

Alush Shala (PDK): Unë edhe sikur të gjithë parafolësit e mi nuk jam kundër këtij projekt propozimi. Por më vjen keq, pse ta quajmë të jashtëzakonshme, kur ka mund me qenë në një seancë të zakonshme. Dhe ky ridestininim do të shkoj më siguri atu ku ka nevojë. Më siguri ju e keni paraparë. Por mendoj që absolutisht nuk kishte me qenë e dëmshme dhe si kishte bërë keq as komunës së Prizrenit dhe as Kuvendit, sikur edhe të ishte ftuar KPF-ca, të njoftohej. E di i kuptojmë gjërat, e dimë se kryetari ka të drejtë. Nuk po kërkoj me ia marrë atë të drejtë. Por realisht do të kishte qenë mirë kryesues për juve edhe të njihemi me komunitetin edhe të sqarohemi më konkretisht. Megjithatë shefi i grupit tonë parlamentar e dha mendimin e grupit parlamentar, do më thënë që përkrahet. Po tjera herë kisha dashtë sinqerisht nëse donë të ketë bashkëpunim të mirë edhe me opozitën. Mirë është të jeni më afër pozitës. Desha të pyes kryetarin, e di se është seancë e jashtëzakonshme. A e rregullove kompjuterin dhe a i zbulove ato fajlle që na ke thënë. Dhe nëse jo, sinqerisht unë e kam ndreq një kompjuter 10 € më ka kushtua. Unë e di që keni mundësi dhe keni fuqi ekzekutive, që ju mi ble jo një, po dhjetë kompjuter. Dhe jam i bindur që ky Kuvend nuk do të kundërshton. Pse po e bënë gjë të tillë, sepse unë e di që është mjet i punës. Edhe në fund kryesues tu kisha lutë që ti mësosh kuvendarët tonë që borxhet e mbetura. Nuk mund ti shet livadhet as ky kryetari tash livadhet e veta mi pagua borxhet që mund të mbesin për projekte të caktuara. Sepse dihet në çfarë faze edhe nënshkruhen kontratat. Po s'ka mund as Ramadan Muja mi shit livadhet, se edhe s'ka për me na lënë neve zero, zero. Andaj nëse ka diçka korruptive, urdhëroni qitni. Dhe sinqerisht do ta keni përkrahjen mi ndjek kriminelet kudo që janë. Qofshin të mitë, qofshin të juajit, qofshin të kujt do.

Dafina Bllaca (PDK): Të nderuar më lejoni të potencoj se rritja e mjeteve nga të hyrat vetanake në shumën prej 1.000.000.00 €, mbi 1.000.000.00 €. Është një arritje e padiskutueshme e qeverisjes së udhëhequr nga PDK-së. Sado që disa zëra jo profesionist mundohen ta shpërfillin punën PDK-së. Duke manipuluar me qytetarët, nën pretekstin se qeverisja e PDK-së ka shpenzuar para në lukset e tyre. Rritje e buxhetit mbi 1.000.000.00 €, punën e përkushtuar, vullnetin, menaxhimin e mirëfilltë të buxhetit të komunës së Prizrenit. Shuma e mjeteve për të cilën ne debatojmë, pa dyshim është kontribut i qytetarëve tanë. Andaj zonja dhe zotërinj është tejet e rëndësishme që këto mjete të tatimpaguesve tanë të adresohen aty ku është më se e nevojshme. Aty ku do të shërbejnë në ngritjen e mirëqenies të qytetarëve tanë. Aty ku do të mund të ngrinin vlerat tona kulturore e artistike, sportive dhe historike, që ka qyteti piktoresk i Prizrenit. Duke hasur në mirëkuptim me këtë ndarje të buxhetit të lartë cekur për këto të hyra vetanake. Përsëritim gjithashtu shumën e ndarë

për mbështetjen e klubeve sportive dhe teatrit. Ku më këtë shihet se tradita e PDK-së, në mbështetje të këtyre klubeve sportive vazhdon edhe tani. Pasi që është në mbështetje e natyrës së veçantë dhe mjaftë e rëndësishme. Më qëllim që tu mundësohet të rinjve tanë qasje më e lehtë në këtë sferë. Sepse në fund të fundit talentet kosovarë kanë dëshmuar vetveten nëpër botë. Duke qenë ambasadorët më të mirë të vendit tonë. Klubet sportive, “Liria”, “Bashkimi” si dhe Teatri kanë qenë dhe mbetën krenaria e Prizrenit në sport dhe kulturë.

Behar Begaj (LDK): Unë jam pro këtij shqyrtimi të këtij projektbuxheti që është paraparë nga KPF-ca. Unë kisha një kërkesë, duke e parë se Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po e shoh që është bërë një ndarje. Po ju falënderoj për këtë buxhet që e keni ndarë. Por ky buxhet besoj që është pak i mangët. Duke e parë se çdo ditë po shuhen edhe klubet e sportit. Pavarësisht të futbollit apo qoftë edhe të sporteve të ndryshme. Duke e parë se ky buxhet është ndoshta pak i kënaqshëm. Unë kisha kërkuar nga ju që ky buxhet të rritet të paktën edhe për 30.000.00 €. Kjo ishte ajo që mua më ka brengos gjatë këtij rishikim të këtij buxheti.

Nazife Kokollari (LVV): Sot në këtë seancë të jashtëzakonshme është shumë më rëndësi që të informohet opinioni i gjerë politikë dhe ai qytetarë. Se për herë të parë pas një qeverisje tetëmbëdhjetë vjeçare nga pushteti paraprak është arritur të tejkalohet planifikimi i të hyrave vetanake në vitin 2017. Dhe kjo gjë është mjaftë pozitive dhe e leverdishme për qytetarët e Prizrenit. Pasi që çdo kontribut dhe taksë e paguar nga ata. Do të menaxhohet dhe do të përdoret për të mirë për interesin e përgjithshëm dhe nevojave të përditshme ditore në shumë sfera dhe aktivitete sociale të tyre. Është shumë interesat dhe e rëndësishme të ceket se pushteti paraprak, edhe pse e kishte formuar një faskforcë, për rritjen e efikasitetit të vjeljes së të hyrave vetanake, nuk kishte arritur asnjëherë të tregoj sukses. Është mirë dhe e dobishme që rritja e mjeteve dhe të ardhurave vetanake të shfrytëzohet dhe të përdoret për aktivitete të rëndësishme sociale. Si në shëndetësi, duke i pajisur qendrat e mjekësisë familjare me aparatura të nevojshme për ushtrimin e profesionit të mjekëve. Pastaj duhet sa më shpejt të funksionalizoj premtimi për sigurimin e shujtave ditore për nxënësit e shkollave të ulëta. Si dhe një pjesë e mjeteve tjera tu dedikohet shkollave, në financimin e sigurimit privat në shkolla. Pasi që shumë herë ka ndodh, që në shkollat e qytetit tonë, sigurimi të financohet nga vetë prindërit e fëmijëve. Pasi që kjo gjë nuk është bërë nga buxheti komunal. Unë si këshilltare e Kuvendit, kisha propozuar që ekzekutivi i tanishëm të evidentoj dhe ti mbikëqyr të gjitha pronat dhe asetet komunale. Më qëllim të rritjes së efikasitetit të rritjes së të hyrave vetanake. Pasi që edhe shumë prona komunale keq menaxhohen. Si dhe personat të caktuar nuk i paguajnë taksat dhe obligimet e tyre. Ky fenomen shkon në radhë të parë në dëm të qytetit dhe përmirësimit të jetesës së qytetarëve.

Simir Krasniqi: Dua t'ia bëjë me dije koleges, që buxheti nga të hyrat vetanake, nuk është merit e juaj. Ky buxhet është i vitit 2017. Dhe të shohim fundin e vitit se si do ta menaxhoni ju si parti.

Dafina Alishani (LVV): Pajtohem me grupin e opozitës, është sukses i qeverisë së kaluar. Gjithmonë edhe kur ka qenë edhe zbukurimi i qytetit. Vet kryetari e ka cek se ka qenë përzgjedhje e qeverisë së kaluar. Edhe krejt ky sukcesi nuk është vetëm i kryetarit të kaluar. Po askush nuk e përmendi edhe drejtorin e qeverisë së kaluar, z. Ertan Simitçiu. Që ka bërë një menaxhim të duhur edhe këto të hyra kanë ardhur ku kanë ardhur. Ju faleminderit shumë për përgjegjësinë që e keni treguar z. Drejtor.

Ilir Baldedaj: Po shohë te ndryshimi i emërtimeve të drejtorive. A është gabim drejtorë i Financës, sepse ju e përpiloni këtë dokument. Po shoh Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencë. Në buxhet p.sh. shërbime sociale. Aty duhet me shënua që janë të parapara në Statutin e komunës. Sepse këtu kemi tash Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencë. Na e kemi një drejtori të ndarë. Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë. Drejtor kisha dashtë me ditë, a është ndryshim i emërtimeve të drejtorive apo është ndonjë përvjedhje.

Ertan Simitçi: Kështu Ilir, sipas ligjit për buxhetin e Kosovës. Të gjitha komunat i kanë disa drejtori që janë të përbashkëta. Edhe në ligjin në komunën e Prizrenit edhe Mirëqenia sociale p.sh. përfshihet në administratën e shëndetësisë. Edhe Emergjencia janë në Shërbime Publike brenda. Por me Statutin e komunës është ndaras, për shkak të menaxhimit. Por nuk ka ndonjë ndryshim. Ka qenë, do të vërtetohet edhe me dokumentet e kaluara. Po më duket z. Hazizi tha për projektet e viteve të kaluara, janë do borxhe të viteve të kaluara. Drejtoria e Financave e ka përfundua raportin final për vitin 2017. Raporti financiar është në procesin e kthimit në shërbimin e kuvendit. Besoj që brenda pesë apo dhjet ditëve do të përfundohet, në seancën e radhës nëse kalon nga KPF-ca, do të shqyrtohet edhe në seancë.

Kryesuesi: Falënderoj të gjithë anëtarët për kontributin e tyre në debat, për sugjerimet, detyrimet. Dhe para se të shkojmë në votim, fjalën ia kaloj kryetarit të komunës Prof. Dr. Mytahir Haskuka për disa sqarime.

Prof. Dr. Mytahir Haskuka, Kryetar i Komunës: Disa pyetjeve vetëm ti përgjigjem dhe të jap disa shpjegime. Së para ju falënderoj për mbështetjen e të gjitha partive të cilat janë në Kuvend, lidhur me shpërndarjen e të hyrave të cilat janë mbi shumën e planifikuar. Kjo nuk është rishikim i buxhetit, por vijat të cilat kanë qenë do të shpërndahen ato sipas kërkesave, apo sipas nevojave të cilat janë në pika të ndryshme. Me njëherë pas vitit të ri, kur thesari faktikisht

filloj të punoj, në shumicën e drejtorive kemi pas tërheqje të fondeve nga thesari, për shkak të kërkesave të përmbaruesve. Edhe në shumë pika kemi pas probleme. Këto i kemi si p.sh. 200.000.00 € të alokuara përfshihen në larjen e rrugëve. Nga se vitin e kaluar nuk janë paguar këto kompani të cilat kanë qenë të kontraktuara për këto shërbime edhe për pastrimin e borës, katër muaj. Dhe punëtorët të këtyre kompanive kanë qenë para grevës në fillim të janarit. Prandaj, janë alokuar menjëherë këto mjete, në mënyrë që ti paguajmë këto kompani dhe të mos kemi probleme. Si po shihet edhe moti po vazhdon të jetë i keq, po vazhdon të bie bor. Prandaj, këtu faktikisht kisha dashtë me i falënderuar punëtorët të kompanive të cilët kanë punuar. Edhe pse nuk kanë qenë të kompensuar. Në anën tjetër, nuk është vetëm në Shërbimet Publike që kemi pas kërkesa nga përmbaruesit. Ka qenë njëjtë edhe në drejtorit tjera, edhe në administratë edhe arsim e kështu më radhë. Prandaj, kjo vetëm në aspektin e shpjegimit, se do të dal edhe me shifrat të cilat janë tërheq menjëherë pas hapjes së thesarit nga përmbaruesit. Edhe një problematik që e adresova me Ministrinë e Financave, dhe besoj që tash e tutje nuk do të kemi probleme të tilla. Ministria e Financave, faktikisht thesari këto mjete i ka tërheq nga kodet pa na pyet neve. Vija buxhetore kemi pas probleme në pagesën e shërbimeve të cilat komuna i ka pas të kontraktuara edhe kërkuva nga ata, që në ardhmen të pyesin komunën, prej nga mi marrë këto mjetet të cilat janë kërkuar nga përmbaruesit të ndryshëm. Për kompjuter, e bleva kompjuterin, faleminderit jam duke vazhdua te punua. Këtu po shohim që i kemi dhënë sportit 90.000.00 €. Po drejt më thënë, na javën e kaluar i paguam borxhet ndaj “Lirisë” dhe “Bashkimit” të cilat janë të hyrat 200.000.00 €. Të cilat janë në buxhetin e këtij viti, po janë borxhe të vitit të kaluar. Tash në momentin që i kemi paguar 200.000.00 €, “Lirisë” dhe “Bashkimit” nga viti i kaluar. Sivjet për sportin po na mbetën vetëm 80.000.00 €. Kjo është gjendja në disa fusha. Prandaj mirënjohjet duhet ti tregojmë, por edhe problemet duhet ti tregojmë. Vetëm thash në aspektin e shpjegimit të gjendjes.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar, edhe njëherë ju falënderoj të gjithë anëtarët. Përfundoj zonjë debati, tash jemi në votim. Ju kisha lut që të gjitha sugjerimet ti bëni edhe në mbledhjet tjera. Po shkojmë në votim sepse besoj që u shtjerr gjithë debati.

Dafina Bllaca: I propozoj kryetarit të ndaj një shumë për të mbajtur kurse. Qoftë kryetari, qoftë ne, le të na paguan edhe neve. Sepse shumë e vështirë është për ta marrë vesh kur po flet. Ose le ta mëson ky shqipen, ose po e mësojë në turqishten.

Kryesuesi: Ju kisha lut, po mundohem unë këtu që ta respektoj rregulloren. Ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit këtu ta respektojnë rregulloren. Kush ka problem me kuptua gjuhën amtare, atëherë është problem i tyre.

Kuvendi komunal, nuk paguan kurse këtu. Edhe nuk ka asgjë të keqe këtu edhe me ditë gjuhë tjera edhe ku ta di unë. Po sidoqoftë komplet e panevojshme ishte kjo. 35 anëtarë jemi të pranishëm në sallë.

Shukri Quni (PDK): Artan, prit pak prit, ti e ke marrë fjalën pa pyet askënd hiq prit tash. Mos u ngut.

Kryesuesi: I nderuar jemi në proces...

Quni: Edhe ne jemi kon në proces të gjithë, prit. Kemi ardhur këtu në Kuvend duhet me debatua deri sa të gjithë të shtjerrën. Gane e respektojmë ne rregulloren shumë mirë. Me ty s'është kërkush ka flet hiq, s'ke nevojë ti mu ngut. Ti vetëm je vetëm me dhënë fjalën edhe me ndal. Çka folin këta tek filin kjo është puna e këtyre. Fjalë të cilat i ke përdor ti në këtë Kuvend, mos kujto, se krejt kanë me tu kthye. Kurrë nuk i ke thënë kryetarit kryetar, po i ke thënë kriminel, hajn, gjithçka. Mos u ngut tash. Ti mos u përgjigj kurrë në emër të kryetari, ai përgjigjet vetë. Kurrë Kujtimi se ka dhënë përgjigjen për kryetarit. Kështu që ti përgjigjet e tua i ke.

Kryesuesi: Tani ju ftoj që ta ndërprejmë debatin. Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për këshillat për sugjerimet. 34 anëtarë jemi prezentë në sallë, ftoj që ta hedhim këtë pikë të rendit të ditës në votim.

Kush është për? – Të gjithë.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatoj se me shumicë votash është miratua vendimi për rritjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017.

Ju faleminderit për pjesëmarrje. Besoj që do të jeni të informuar për mbledhjen e radhës. Gjithashtu edhe një njoftim shumë shkurt për anëtarët e Kuvendit. Imejll adresat zyrtare të cilat i keni plotësuar aplikacionin, do t'ju vinë të dhënat dhe udhëzimet në imellat e juaj privat. Pra keni kujdes, kushtoni rëndësi. Dhe për ata të cilët kanë vështirësi në kuptimin e udhëzimeve. Atëherë ju ftojme që këtë ta bëjnë në konsultim me personin zyrtar të ATI-së.

Faleminderit dhe mirë u pafshim në mbledhjen e radhës.

Përfundoi në orën 10:50.

Procesmbajtësi
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi